

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-24-13325-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i rrugëve , kanalizimit dhe ndriqimit publik në fshatin Krajk - Projekt tre vjeçar**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Seticommerc SH.P.K.
NUI	810633116
Adresa	Shiroke-Suharek
Vendi	SHIROKË
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	+383 43776700
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ditjon Bajraktari
Adresa elektronike	seticommercshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	27.03.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ndërtimi i rrugëve , kanalizimit dhe ndriqimit publik në fshatin Krajk - Projekt tre vjeçar

Ndërtimi i rrugëve , kanalizimit dhe ndriqimit publik në fshatin Krajk - Projekt tre vjeçar

Njoftim mbi kontratë : 19.12.2024

Dorëzimi dhe hapja: 11.02.2025

Njoftim për vendimin : 11.03.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesë për rishqyrtim të vendimit: 15.03.2025

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim: 18.03.2025

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit,

dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Legjislacioni primar: Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Specifikisht të neneve:

Neni 1 - Qëllimi

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 11 - Informatat Sekrete Afariste

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E

RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)

Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të pa kënaqur me njoftimin e date 11.03.2025 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prizrenit në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, konsiderojmë se në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT) me arsyetimin se ju mungojnë:

4.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar i Ndertimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, master me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit.

Dëshmia 4 • Diplomat përkatëse – Kopje Diplomat të cilat nuk janë të RKS duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT. • CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); • Kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për këtë projekt; • Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit; • Një deklaratë me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vëltur nga Operatori Ekonomik për pikën 4.1.

- Përvoja e punës për Menaxherin e Projektit të emëruar nga OE;

- Ard Group periudha 20.08.2009 – 14.11.2021

- Ard Group periudha 31.08.2009 – 14.09.2009 – janë dy vërtetime për të njëjtën periudhë

- Erst Bau – Ndërtimi i infrastrukturës në parkun industrial Lumbardh nr prokurim; 204-18-8650-5-1-1 – pjesa e mbetur e kontratës, nuk është mbiqyr komplet kontrata për periudhë kur është bërë mbikqyrja e këtij projektit që e ka paraqit edhe në CV-në e tij periudha 01.04.2021 – 01.11.2021. dmth menaxheri i projektit zt. MR nuk e përmbush

kriterin sipas DT qe eshte kerkuar 5 vite pervoje pune pas diplomimit me referen per punët e kryera .

- Ing i ndertimtaris UK posedon nje qertifikat me nr; ISO 9001-2015 IC -06-2420- Lead Enternal Auditor , ndërsa ne dosjen e tenderit eshte kërkuara.

- Ingjinier i diplomuar i ndertimtaris konstruktiv me 5 vite pervoje pune. Te jete i paisur me Certifikaten Auditor i sistemit te menaxhimit te cilesis sipas 6001:2015 – nuk e plotëson krieterin sipas dosjes se tenderit.

4.6. Një Inxhinier i Diplomuar i Ndertimtarise ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit. Te jete i pajisur me certificate auditor i sistemit te menaxhimit te cilesise sipas ISO 9001 2015,

- Ingjinier i diplomuar i ndertimtaris konstruktiv me 5 vite pervoje pune. Te jete i paisur me Certifikaten Auditor i sistemit te menaxhimit te cilesis sipas 6001:2015 – nuk e plotëson krieterin sipas dosjes se tenderit.

Pretendimi 1:

Në lidhje me eliminimin tonë nga tenderi për: 4.1. Menaxheri i Projektit - Inxhinier i Diplomuar i Ndertimtarise ose master - Drejtimi Konstruktiv, master me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit. Dëshmia 4 - Diplomat përkatëse - Kopje Diplomat të cilat nuk janë të RKS duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT. - CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); - Kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për këtë projekt; - Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit; - Një deklaratë me shkrim per caktimin e menaxherit te projektit - duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 4.1. ju sqaroj se:

Përvoja e punës së menaxherit të projektit është nga viti 2009 (viti i diplomimit) deri në vitin 2025 që i bie mbi 16 vite përvojë punë, gjë që e vërteton Diploma dhe CV e bashkangjitur në dosjen e tenderit në rastin e tenderimit. Për arsyen e eliminimit se janë 2 vërtetime nga kompania Ard Group për të njejtën periudhë ju sqaroj se njëri Vërtetim është për projektin Zgjerimi i rrugës Nacionale M9_Fushë Kosovë - Gjurgjicë ndërsa tjetri i përket projektit Asfaltimi i rrugës Bardh (ish Lladroviq) Senik Komuna Malishevë, pra janë për projekte të ndryshme dhe ashtu siq e keni cek dhe ju njëri përfundon në vitin 2010 dhe tjetri 2009. Për Referencën e kompanisë Erst Bau - Ndertimi i infrastrukturës ne parkun industrial Lumbardh nr prokurim; 204-18-8650-5-1-1 - pjesa e mbetur e kontratës, ju sqaroj se ky projekt ka zgjat disa vite deri sa është përfunduar dhe se është krejt normale që nëse një projekt zgjat disa vite ka mundësi të ndrrohen dhe inxhinierët. Ju si AK e keni shtuar kriterin **"me referenc per punët e kryera" në B42 Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar -3, vetëm të na eliminoni neve si kompani pa të drejtë sepse ky kriter as nuk ishte i specifikuar në pikën "4.1. Menaxheri i Projektit" dhe as nuk ishte i kërkuar në "Dëshmia 4". Kjo kërkesë është shtuar vetëm në B42 Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar -3 dhe ky pretendim i juaji nuk qëndron.**

Pretendimi 2:

Në lidhje me eliminimin tonë nga tenderi për: 4.6. Një Inxhinier i Diplomuar i Ndertimtarise ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit. Te jete i pajisur me certificate auditor i sistemit te menaxhimit te cilesise sipas ISO 9001 2015, me pretendimin se: Ingjinier i diplomuar i ndertimtaris konstruktiv me 5 vite pervoje pune. Te jete i paisur me Certifikaten Auditor i sistemit te menaxhimit te cilesis sipas 6001:2015 – nuk e plotëson krieterin sipas dosjes se tenderit. Ju sqaroj se: **Inxhinieri Uzeri Kapllani është Inxhinier i Diplomuar i Ndertimtarise dhe poashtu**

është i Certifikuar me Certifikatë ISO 9001:2015 dhe se Certifikata është e bashkangjitur në rastin e dorëzimit të tenderit. Pretendimi i juaj se keni kërkuar Certifikatë ISO 6001:2015, dhe se ky pretendim është i përsëritur 2 herë në B42 Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar -3, nuk qëndron fare sepse është kërkuar Certifikatë ISO 9001:2015.

Pretendimi 3:

Ne me datë 11.03.2025 kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik për OE e propozuar për kontratë dhe se kjo qasje na është dhënë 14.03.2025 nga ora 10:00. Bazuar në RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar), Neni 7 Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion, paragrafin 7.6.3 Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

Ju si AK e keni shkelur këtë Nen të rregullores dukë mos na lejuar qasje të menjëhershme në verzionin e pastruar.

Pas pranimit të dokumenteve tenderuese të OE të poropozuar për kontratë, kemi vërejtur se shumë pak dokumente na janë ofruar dhe se OE i propozuar për kontratë i kishte cilësuar si Sekret Afarist pothuaj të gjitha dokumentet e tenderit. Neve na janë ofruar vetëm: Certifikta e Biznesit, Deklarata nën Betim, Certifikatat ISO të kompanisë dhe Sigurimi i Tenderit. Pyetje: çfarë sekreti afarist janë kontratat e realizuara? çfarë sekreti afarist janë numri i punëtorëve? çfarë sekreti afarist janë inxhinierët (për të cilët ne jemi eliminuar)? Dhe më kryesorja: çfarë sekreti afarist janë paisjet teknike (makineria)?

Bazuar në RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK - Versioni i konsoliduar, paragrafi 7.6.1 Autoriteti Kontraktues nuk do të klasifikojë një informatë si sekret afarist, nëse OE nuk e ka plotësuar Aneksin 3 të Dosjes së tenderit me të gjitha informacionet e kërkuara në këtë formular, me theks të veçantë poqëse nuk i ka paraqitë të gjitha faktet dhe argumentet me të cilat OE dëshmon se zbulimi i një informacioni do t'i shkaktojë dëm material biznesit të tij. 7.6.2 Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit menjëherë pas procesit të hapjes së ofertave dhe para publikimit të B58 -Njoftimi mbi vendimin e AK-së-, duhet të përgatitë versionin e pastruar në përputhje me paragrafin 4 të nenit 11 të LPP-së dhe të njoftojë palën. Në lidhje me këtë ju sqaroj se:

OE i propozuar për kontratë nuk i ka paraqitë asnjë fakt dhe argument me të cilat OE dëshmon se zbulimi i një informacioni do ti shkaktojë dëm material biznesit të tij. Me këtë veprim duke mos i kërkuar fakte dhe argumente OE të propozuar për kontratë, ju si AK e keni shkelur Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion të RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK - Versioni i konsoliduar dukë mos na lejuar qasje në këto dokumente.

Komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit ka bërë shkeljen e deklaratës nën betim Sipas Neneve 1,11, 59 dhe 72 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin

Nr. 05/L-092 duke mos zbatuar detyrën për të cilën edhe e ka nënshkruar këtë deklaratë duke eliminuar kompaninë tonë për kritere të kanë mundur të kërkohej sqarim. Me eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit dhe me shpalljen fitues të OE "EdiBauing", AK e ka favorizuar drejt për se drejti OE të rekomanduar për kontratë ndërsa na ka diskriminuar dhe na ka dëmtuar neve drejtpërsëdrejti.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë Nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Zyrtaret e AK me këtë vendim po tentojnë ta dëmtojnë buxhetin e Komunës në vlerë prej 160,320.15Euro pasi ka pretenduar për të shpërblyer me kontratë një OE më të shtrenjtë sesa neve.

Me këtë veprim AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Pra ne kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit dhe kemi ofertuar me tenderin me çmim më të ulët.

Prandaj bazuar në provat deshmitë dhe argumentet e sipër përshkruara, kërkojmë nga AK që të ndërmarrë veprimet ligjore dhe të aprovohet Ankesa jone në tërësi dhe të merret:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e kompanisë sonë.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe pas rivlerësimit të shpallemi fitues i këtij aktiviteti të prokurimit, në të kundërtën nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkelja e dispozitave të mësipërme, tentojnë t'i shkaktojnë dëme të konsiderueshme kompanisë sonë, të cilat përpos dëmeve materiale që kanë të bëjnë me shpenzimet e ofertimit në këtë aktivitet dhe fitimit të munguar, gjithashtu tentojnë të na shkaktojnë dëme të mëdha edhe në imazhin e kompanisë sonë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmitë) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.